



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.65**

**14 qershor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 317, datë 17.5.2012	Për lejimin e ekspozimit të disa dokumenteve origjinale dhe objekteve të rralla me vlera historike, ikona dhe kodikë, në Strasburg, në kuadër të marrjes së kryesisë së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, nga data 23-25 maj 2012	3179
Vendim i KM nr. 318, datë 16.5.2012	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çështjen nr. 9074/07 “Mullai dhe të tjerë kundër Shqipërisë” .....	3180
Vendim i KM nr. 322, datë 16.5.2012	Për miratimin e protokollit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke, për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, të prillit 2005 .....	3181
Vendim i KM nr. 323, datë 16.5.2012	Për një ndryshim në vendimin nr.916, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore” .....	3187
Vendim i KM nr. 324, datë 16.5.2012	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.....	3189
Vendim i KM nr. 325, datë 16.5.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që tranferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Vllahinë, të qarkut të Vlorës...	3189
Vendim i KM nr. 326, datë 16.5.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar.....	3190

Vendim i KM nr. 327, datë 16.5.2012	Për kalimin e objektit “Ish-posta kufitare, Tamarë”, nga Ministria e Brendshme, në pronësi të komunës Kelmend, të qarkut të Shkodrës, si dhe për një ndryshim në vendimin nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”.....	3191
Vendim i KM nr. 328, datë 16.5.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 109, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Nikël, të qarkut të Durrësit”.....	3193
Vendim i KM nr. 329, datë 16.5.2012	Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.....	3193
Vendim i KM nr. 330, datë 16.5.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për pagesën e shpenzimeve administrative të arbitrazhit ndërkombëtar për çështjen nr.ARB/11/24 “Mamidoil Jetoil Greek Petroleum Products Societe Anonyme S.A. kundër Republikës së Shqipërisë”....	3197
Vendim i KM nr. 331, datë 16.5.2012	Për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. ARB/11/24 “Mamidoil Jetoil Greek Petroleum Products Societe Anonyme S.A. kundër Republikës së Shqipërisë”....	3198
Vendim i KM nr. 332, datë 16.5.2012	Për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. ARB/11/18 “Burimi s.r.l.&Eagle Games, sh.a. kundër Republikës së Shqipërisë”.....	3198
Vendim i KM nr. 333, datë 16.5.2012	Për miratimin e rialokimit të fondeve të akorduara, sipas kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë.....	3199
Vendim i KM nr. 334, datë 16.5.2012	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkozë-Durrës .....	3200
Vendim i KM nr. 335, datë 16.5.2012	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor hyrja-Shkodër.....	3202
Vendim i KM nr. 337, datë 16.5.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 522, datë 30.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga shpronësimi për qëllim të ndërtimit, pronësisë, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të shtetit të projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në qarkun e Shkodrës”.....	3203

Vendim i KM nr.354, datë 23.5.2012	Për pezullimin e pjeshëm dhe të përkohshëm të licencës së shkollës së lartë universitare jopublike, universiteti “Kristal” .....	3205
Vendim i KM nr. 383, datë 6.6.2012	Për miratimin e marëveshjes me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në det në Shqipëri, bllloqet 2, 3 dhe 4 të Adriatikut, ndërmjet “Albpetrol”, sh.a.-së, dhe shoqërisë “Emanuelle Adriatic Energy Limited” .....	3205
Kërkesë e MPPT nr.872/7, datë 21.5.2012	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Bulevardi “Bajram Curri”-rruga “Ali Demi”, faza II”, Tiranë.....	3206

**VENDIM**  
**Nr. 317, datë 17.5.2012**

**PËR LEJIMIN E EKSPOZIMIT TË DISA DOKUMENTEVE ORIGJINALE DHE OBJEKTEVE  
TË RRALLA ME VLERA HISTORIKE, IKONA DHE KODIKË, NË STRASBURG, NË  
KUADËR TË MARRJES SË KRYESISË SË KOMITETIT TË MINISTRAVE TË KËSHILLIT TË  
EUROPËS, NGA DATA 23-25 MAJ 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e ekspozimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të disa dokumenteve origjinale dhe objekteve të rralla me vlera historike, ikona dhe kodikë, në Strasburg, në kuadër të marrjes së kryesisë së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, nga data 23-25 maj 2012, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme të kryejë shoqërimin dhe kthimin e ikonave e të kodikëve në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**LIDHJA NR. 1**

I. Muzeu Kombëtar “Onufri” në Berat, në varësi nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, do të vendosë në dispozicion të MPJ-së, për ekspozim në Strasburg ikonat si vijon:

1. Ikona “Prezantimi në tempull” shek. XVI, autori: Onufri, vlera 5 000 000 lekë (pesë milionë) lekë;

2. Ikona “Burimi jetëdhënës” shek. XVII, autori: anonim, vlera 500 000 lekë (pesëqind mijë) lekë;

3. Ikona “Darka mistike”, shek. XVIII, autori: anonim, vlera 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

II. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave do të vendosë në dispozicion të MPJ-së dokumentet origjinale, si vijon:

1. 2 (dy) fletë nga Kodiku i Beratinus 1, shek. VI;

2. 2 (dy) fletë nga Kodiku i Beratinus 2, shek. IX;

3. Kapaku i Kodikut Beratinus 1, punuar në argjend, viti 1805.

**Beratinus 1**

- Teknika: dorëshkrim, tekst me germa argjendi në pergamenë të purpurt

- Kultura: bizantine

- Periudha: shek VI

- Autori: anonim

- Dimensionet: 230x215 mm

- Sasia: 2 fletë



## **Beratinus 2**

- Teknika: dorëshkrim, tekst me germa ari në pergamenë të purpurt (sot paraqitet blu e errët me nuanca rozë)

- Kultura: bizantine
- Periudha: shek. IX
- Autori: anonim
- Dimensionet: 230x185 mm
- Sasia: 2 fletë

## **Kapakët e Beratinus 1**

- Teknika: kapakë argjendi të punuar me kuposje dhe incizim
  - Kultura: artizanale e periudhës osmane
  - Periudha: viti 1805
  - Autori: anonim
  - Dimensionet: 320x280 mm
  - Sasia: 1 (fleta e sipërme dhe e poshtme e kapakut janë të lidhura me njëra-tjetrën)
- Vlera totale për të pesta objektet është 100 000 (njëqind mijë) euro.

## **VENDIM**

**Nr. 318, datë 16.5.2012**

### **PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, PËR ÇËSHTJEN NR. 9074/07 “MULLAI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

## **VENDOSI:**

1. Ekzekutimin e vendimit nr. 9074/07, datë 18.10.2011 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çështjen “Mullai dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në shumën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro në favor të ankuesve Mullai etj. dhe 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) euro në favor të shoqërisë “Teknoproject” sh.p.k., plus çdo tatim që mund të vendoset.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Vlefshmëria e lejes së ndërtimit nr. 766, datë 22.12.1998 të Bashkisë Tiranë, të zgjatet edhe për dy vjet, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe të garantojë kryerjen e pandërprerë të punimeve të ndërtimit gjatë kësaj periudhe.

4. Shuma prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) eurosh, e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve: znj.Nesime Mullai, z.Astrit Daci, znj.Mediha Hoti, znj.Suzana Zereliu, znj.Nermin Daci, znj.Etleva Mullai dhe znj.Eva Pinguli, kurse shuma prej 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) eurosh të depozitohet në emër të shoqërisë “Teknoproject” sh.p.k. dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma në datën e çeljes së llogarisë.

5. Pagimi i shumë, sipas pikës 4 të këtij vendimi, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda datës 18 maj 2012. Në rast mospagimi brenda këtij afati, mbi shumën e 3180

mësipërme paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marxhinal të huas së Bankës Qendrore Europiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
Nr. 322, datë 16.5.2012

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ÇEKE, PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR, TË PRILLIT 2005**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e protokollit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, të prillit 2005.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**PROTOKOLL**  
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ÇEKE, PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR, TË 14 PRILLIT 2005

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Çeke (më poshtë referuar si palët kontraktuese)

*me dëshirën* për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, të datës 14 prill 2005 (më poshtë referuar si “marrëveshja e ripranimit”),

bazuar në nenin 19 të saj

kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1  
**Dispozitë e përgjithshme**

Ky protokoll parashikon rregulla të hollësishme për zbatimin e marrëveshjes së ripranimit në marrëdhëniet mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke. Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë protokoll do të interpretohen siç përcaktohen në marrëveshjen e ripranimit.



## Neni 2 Autoritetet kompetente

1. Autoriteteve të mëposhtme do t'u besohet zbatimi i marrëveshjes së ripranimit në përputhje me nenin 19 paragrafin 1 pikën a të saj (më poshtë referuar si "autoritete kompetente"):

Për palën shqiptare  
Ministria e Brendshme  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit  
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin  
Drejtoria e Migracionit dhe Ripranimeve  
Bulevardi "Bajram Curri", Tiranë  
Tel: 00355 4 227 9251  
00355 4 227 9253  
00355 4 227 9241  
Fax: 00355 4 222 6932; 00355 4 227 9263  
E-mail: [policiakufitare.migracioni@mrp.gov.al](mailto:policiakufitare.migracioni@mrp.gov.al)

Për palën çeke:  
Policia e Republikës Çeke  
Drejtoria e Shërbimit Policor të të Huajve  
Adresa: Olsanska 2, P.O.BOX 78  
130 51 Prague 3  
Tel: 00 420 974 841 826  
Fax: 00 420 974 841 839  
E-mail: [cocpp@mvr.cz](mailto:cocpp@mvr.cz)

2. Palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën pa vonesë mbi çdo ndryshim në lidhje me autoritete kompetente, adresat dhe kontaktet e tyre.

## Neni 3 Mjetet e komunikimit

1. Aplikimet për ripranim dhe transit do t'u dorëzohen autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese në parim me faks.

2. Përgjigjet për aplikimin e ripranimit ose transitit ose komunikimi tjetër që lidhet me to, që nuk përmban të dhëna personale të personit subjekt i ripranimit ose transitit, në parim do të bëhen nëpërmjet mjeteve elektronike ose duke përdorur mjete të tjera teknike të komunikimit dhe do t'i referohet numrit të referencës së aplikimit.

## Neni 4 Mjetet dhe dokumentet

1. Për qëllimin e zbatimit të marrëveshjes së ripranimit provat *prima facie* të shtetësisë së një personi do të jepen si shtesë ndaj dokumenteve referuar në aneksin 2 të marrëveshjes së ripranimit nëpërmjet një liste pasagjerësh ose një konfirmimi të shkruar të lëshuar nga kompania e fluturimit e cila transportoi personin në fjalë.

2. Aty ku autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese konsideron që dokumentet e tjera përveç atyre të listuar në anekset 1-4 të marrëveshjes së ripranimit mund të jenë të rëndësishme për përcaktimin e shtetësisë, kushtin për ripranimin e qytetarëve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi, këto dokumente mund t'i bashkëlidhen aplikimit për transit. Shtetësia ose kushtet për ripranimin e 3182

qytetarëve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi do të gjykohet si e përcaktuar në të gjitha rastet e mësipërme që pala kontraktuese e kërkuar e konfirmon.

3. Autoritete kompetente do të shkëmbejnë modelet e kartave të identitetit dhe pasaportave.

#### Neni 5

#### **Intervista**

1. Kërkesa për intervistë në përputhje me nenin 8 paragrafi 3 të marrëveshjes së ripranimit do të futet në seksionin D të aplikimit të ripranimit, një kopje e të cilit do t'i dërgohet në të njëjtën kohë autoritetit diplomatik ose përfaqësuesit konsullor të shtetit të palës kontraktuese së kërkuar.

2. Intervista do të kryhet nga zyrtarë të përfaqësuesit diplomatike ose konsullore të shtetit të palës kontraktuese të kërkuar në një vend të specifikuar nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese. Autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese do të njoftohet mbi rezultatin e intervistës maksimumi pas 10 ditësh kalendarike nga marrja e aplikimit të ripranimit.

3. Kur rezultati i intervistës nuk i njoftohet autoritetit kompetent të palës kontraktuese kërkuese brenda afatit të specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni, ai mund të zëvendësohet me regjistrimin e intervistës me zyrtarë të autoritetit kompetent të palës kontraktuese kërkuese, i cili do t'i dorëzohet pa vonesë autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar.

#### Neni 6

#### **Procedura e ripranimit**

1. Autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese do të plotësojë datën dhe orën e propozuar të transferimit, pikën e hyrjes dhe detajet që lidhen me shoqërime të mundshme në seksionin D të aplikimit të ripranimit, nëse këto detaje dihen në momentin e dorëzimit të aplikimit. Autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar do t'i kthejë përgjigje propozimit në përgjigjen e tij për aplikimin e ripranimit.

2. Aty ku detajet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni nuk janë pjesë e aplikimit të ripranimit, ato do t'i njoftohen nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar jo më vonë se 7 ditë kalendarike para datës së propozuar të transferimit të personit. Autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar do t'i përgjigjet këtij propozimi pa vonesë, por brenda afatit prej 3 ditësh që nga marrja e tij. Kur autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese nuk merr përgjigje, propozimi do të konsiderohet si i pranuar.

3. Nëse personi do të ripranohet nën eskortë, detajet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni përfshijnë emrat dhe mbiemrat, gradat e anëtarëve të eskortës dhe tipin numrin dhe datën e lëshimit të dokumenteve të tyre të udhëtimit. Çdo ndryshim në lidhje me këto detaje duhet njoftuar pa vonesë. Nëse operacioni i ripranimit do të kryhet në rrugë ajrore, anëtarët e eskortës do të përjashtohen nga detyrimi i marrjes së vizës transit në aeroport.

4. Një procesverbal me shkrim i transferimit dhe pranimit të personit nën eskortë do të mbahet në dy kopje. Autoriteti kompetent i secilës palë kontraktuese do të mbajë nga një kopje. Një model i procesverbalit ndodhet në aneksin e këtij protokollit dhe përbën një pjesë integrale të protokollit.

#### Neni 7

#### **Aplikimi për transit**

1. Autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese duhet të paraqesë një aplikim për transit autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar të paktën 7 ditë kalendarike përpara transitit të planifikuar.

2. Autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar duhet t'i përgjigjet maksimumi brenda 3 ditëve kalendarike pas marrjes së aplikimit për transit. Në të njëjtën kohë, duhet t'i përgjigjet propozimit të pikës së hyrjes dhe kohën e transferimit të përfshirë në aplikimin për transit në përputhje me nenin 14 të marrëveshjes së ripranimit.



3. Aplikimi për transit do të përmbajë, nëse është e nevojshme, informacion në përputhje me nenin 7, paragrafi 2 të marrëveshjes së ripranimit.

#### Neni 8

##### **Procedurat e transitit**

1. Në parim, operacioni i transitit duhet të kryhet bëhet nëpërmjet ajrit. Në këtë rast, personi i interesuar duhet të shoqërohet nga eskortat e palës kontraktuese kërkuese. Detajet që lidhen me eskortat, siç janë përcaktuar në nenin 6 paragrafi 3, do të futen në seksionin C të aplikimit për transit. Çdo ndryshim lidhur me këto detaje, duhet të informohet pa vonesë.

2. Anëtarët e eskortës nuk duhet të ushtrorjnë autoritet mbi territorin e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar; ata duhet të kryejnë detyrat e tyre të paarmatosur; ata janë të detyruar të respektojnë sistemin ligjor të shtetit të palës kontraktuese të kërkuar dhe duhet të mbajnë një kopje të miratimit të transitit të lejuar nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar.

3. Autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar duhet t'u japë anëtarëve të eskortës së palës kontraktuese kërkuese mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme. Si pjesë e mbikëqyrjes së personit të interesuar, në përputhje me nenin 14 paragrafi 4 të marrëveshjes së ripranimit, zyrtarët e autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar, mbi të gjitha do të sigurojnë që personi i interesuar nuk del nga zona e transitit të aeroportit dhe hipën në aeroplan.

4. Në rastin e transitit nga toka, personi i interesuar duhet t'u dorëzohet në kufirin shtetëror, zyrtarëve të autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar, të cilët duhet ta shoqërojnë personin drejt kufirit të shtetit të destinacionit, ose të ndonjë shteti transit, sipas rastit.

#### Neni 9

##### **Pikat e kalimit kufitar**

Në përputhje me nenin 19 paragrafi 1 (a) të marrëveshjes së ripranimit, pikat e kalimit kufitar të përcaktuara nga palët kontraktuese për kalimin e kufijve ndërkombëtarë respektivë nëpërmjet ajrit si më poshtë vijon:

a) në Republikën e Shqipërisë:

- Aeroporti ndërkombëtar “Nënë Tereza” – Rinas

b) në Republikën Çeke

- Aeroporti Ruzyne Pragë

- Të tjera aeroporte ndërkombëtare me fluturim direkt nga Shqipëria mund të përdoren pas marrëveshjes paraprake të autoriteteve kompetente.

Në rastin e transferimit nga toka, autoritete kompetente duhet të bien dakord për pikat e kalimit kufitar rast pas rasti.

#### Neni 10

##### **Mbulimi i kostove**

Autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese do të rimbursojë autoritetin kompetent të palës kontraktuese të kërkuar për kostot në përputhje me nenin 15 të marrëveshjes së ripranimit me transfertë bankare në llogarinë e autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së faturës. Palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën për numrat e llogarive të tyre respektivë nëpërmjet kanaleve diplomatike. Norma e rimbursimit do të vendoset nga legjislacioni i shtetit të palës kontraktuese të kërkuar dhe do të bazohet mbi dokumentet që provojnë shumën aktuale të kostove. Kostoja e lëshimit të një dokumenti udhëtimi zëvendësues për personin që do të transferohet do të mbulohet nga pala kontraktuese e kërkuar.

Neni 11  
Gjuhët

1. Aplikimet e ripranimit dhe aplikimet për transit dhe përgjigjej për to do të dërgohen në gjuhën angleze, ose, aty ku është e përshtatshme në gjuhën e palës kontraktuese të cilës i dërgohet. Dokumente të tjera do të dërgohen gjithashtu nëse është e mundur në gjuhën e palës kontraktuese të cilës i adresohen ose në anglisht.

2. Autoritetet kompetente do të komunikojnë në anglisht përveç kur bihet dakord ndryshe mbi bazën e parimit rast pas rasti.

Neni 12  
Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi përmbushjen e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të këtij protokollit.

2. Pas marrjes së njoftimit të fundit mbi përfundimin e procedurave të brendshme ligjore që nevojiten për hyrjen në fuqi të protokollit, pala kontraktuese çeke do të njoftojë komitetin e përbashkët të ripranimeve të referuar në nenin 18 të marrëveshjes së ripranimit. Pala kontraktuese çeke do të informojë palën kontraktuese shqiptare për kryerjen e këtij njoftimi.

3. Protokollit do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë që pason njoftimin e Komitetit të Përbashkët të Ripranimit.

4. Ky protokoll përfundon së pasuri fuqi në të njëjtën ditë me marrëveshjen e ripranimit.

Bërë në Tiranë, më 16.4.2012 në dy kopje në gjuhët shqipe, çeke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllor të barasvlershme. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

ANEKS

I PROTOKOLLIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ÇEKE PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET  
KOMUNITETIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR RIPRANIMIN E  
PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR, TË 14 PRILLIT 2005

.....  
Autoriteti kompetent i Palës kërkuese

Nr. i referencës

.....  
Autoriteti kompetent i Palës kërkuese

TË DHËNA MBI TRANSFERIMIN E PERSONIT TË RIPRANUAR

Në përputhje me nenin 6 paragrafi 4 i Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar të 14 prillit 2005



**A. DETAJE PERSONALE**

1. Emri i plotë (nënvizoni mbiemrin).....
2. Data dhe vendi i lindjes.....
3. Gjinia .....
4. Shtetësia .....

**B. DETAJE PERSONALE TË BASHKËSHORTES/BASHKËSHORTIT SHOQËRUES**

1. Emri i plotë (nënvizoni mbiemrin).....
2. Data dhe vendi i lindjes.....
3. Gjinia .....
4. Shtetësia .....

**C. DETAJE PERSONALE TË FËMIJËVE SHOQËRUES**

1. Emri i plotë (nënvizoni mbiemrin).....
2. Data dhe vendi i lindjes.....
3. Gjinia .....
4. Shtetësia .....

**D. GJENDJA SHËNDETËSORE E PERSONIT QË DO TË TRANSFEROHET**

.....

**E. SENDET PERSONALE DHE PARATË QË KA ME VETE PERSONI QË DO TË RIPRANOHET**

- 1.....
- 2.....
- 3.....

Shënim:.....

(Data) .....

(Vendi).....

Për autoritetin kompetent të palës së kërkuar

Për autoritetin kompetent të palës së kërkuar

Emri:

Mbiemri:

Pozicioni:

Nënshkrimi:

Emri:

Mbiemri:

Pozicioni:

Nënshkrimi:

**VENDIM**  
**Nr. 323, datë 16.5.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 916, DATË 28.12.2011 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË  
PËRKOSSHME, PËR VITIN 2012, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 pika 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 11 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 1 e vendimit nr. 916, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore bëhet 639 veta. Shtesa prej 118 punonjësish është e detajuar sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korente të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2012, të njëjësive të qeverisjes qendrore. Përgjashtimisht për 110 punonjësit e Ministrisë së Brendshme, efektet financiare përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit.

3. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet buxhetore të përmendura sipas lidhjes nr. 3, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve brenda kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 1703, datë 24.12.2008 “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktivitetëve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



Lidhja nr. 3

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. punonjese	Emertesa	Koha mesatare ditore	Periudhe kohore
04	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes	5			
	Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise	5	Roje	6 ore / dite	viatore
06	Ministria e Puneve Publike dhe Transportit	1			
	Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles-Kanalizimeve	1	Pastres	6 ore/dite	viatore
10	Ministria e Financave	1			
	Drejtoria e Pergjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve	1	Protokolli-st-arkivist	6 ore/dite	viatore
16	Ministria e Brendshme	110			
	Shtepia Pushimit Durres	4	guzhiner	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
	Shtepia Pushimit Durres	4	ndihmes guzhier	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
	Shtepia Pushimit Durres	30	kamariet	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
	Shtepia Pushimit Durres	9	punetor restoranti	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
	Shtepia Pushimit Durres	1	teknik	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
	Shtepia Pushimit Durres	6	receptionist	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
	Shtepia Pushimit Durres	16	punetor gjeberimi	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
	Shtepia Pushimit Durres	10	punetor guzhine	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
	Shtepia Pushimit Durres	25	punetor hoteli	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
	Shtepia Pushimit Durres	1	electricist	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
	Shtepia Pushimit Durres	1	hidraulik	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
	Shtepia Pushimit Durres	3	lavanteri	8 ore/dite	01.06.12-30.09.12
29	Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1			
	Gjykata e Rrethit Gjyqesor Kukës	1	Punonjes mirembajtjes	4 ore / dite	viatore
	<b>Total Numri i Punonjeseve</b>	<b>118</b>			

**VENDIM**

**Nr. 324, datë 16.5.2012**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KUVENDIT TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3 dhe 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Kjo listë me 3 (tre) fletë i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi vetëm të ndërtesave dhe të mjediseve ku ushtrohet veprimtaria administrative e këtij institucioni.

3. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**

**VENDIM**

**Nr. 325, datë 16.5.2012**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË  
KOMUNËS VLLAHINË, TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Vllahinë, të qarkut të Vlorës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 826 (tetëqind e njëzet e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Vllahinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**



Komuna Vllahinë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
5-10/4	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
11-32	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
33-50, 51-55	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
56-71	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi
72-235,339-743	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
236-248	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
249,250,252,253,254,256,257, 258,259,261,262,263,264,266, 267,269,270,271,272,274,275, 276,278,279,280,281,283,284,285, 287,288,289,291,292,293,294	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë bujqësore produktive)	Në përdorim. Nuk transferohet sip. 122.28 ha, shtrihet në fshatin Vllahinë, z.k.3801 dhe fshatin Petë z/k.2941. Kjo sip. është dorëzuar në AKKP
251,255,260,265,268,273,277,282,286, 290,295	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta)	Në pronësi
750-768	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

**VENDIM**  
**Nr. 326, datë 16.5.2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 313, DATË 1.7.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E STRUKTURËS, TË NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE TË POLICISË SË BASHKISË DHE KOMUNËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në lidhjen që i bashkëlidhet vendimit nr. 313, datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave, në pikën 3 të kreut XXXI, bëhen këto ndryshime:

1. Numri maksimal i punonjësve të policisë së komunës, për komunën Bogovë, të bëhet 2 (dy) veta.

2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive dhe komunave të bëhet, gjithsej, 1 100 (një mijë e njëqind) veta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 327, datë 16.5.2012**

**PËR KALIMIN E OBJEKTIT “ISH-POSTA KUFITARE, TAMARË”, NGA MINISTERIA E  
BRENDSHME, NË PRONËSI TË KOMUNËS KELMEND, TË QARKUT TË SHKODRËS, SI  
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË  
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI  
MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, si dhe të neneve 3 shkronja “a”, 5 e 6 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin e objektit “Ish-posta kufitare, Tamarë” nga Ministria e Brendshme, në pronësi të komunës Kelmend, të qarkut të Shkodrës, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kjo pronë të hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryetari i komunës Kelmend dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME SHTETËRORE (POSTA E POLICISË KUFITARE TAMARË)  
QË KËRKOHEM NGA KOMUNA KELMEND

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Brendshme  
Komuna: Kelmend

Nr. Rend	A		B				C			
	Zona kadastrale, indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Emërtesa e pronës, vendndodhja/shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m <sup>2</sup>	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
11			Posta e policisë kufitare Tamarë		Truall total	500				Në vlerën e truallit total është pasur parasysht truall i ndërtesës prej 210 m <sup>2</sup> +oborr për objektin 290 m <sup>2</sup>
12				Komanda, zyrat	Qendër	210	Ish/zyra pune	Ministria e Brendshme	Drejtoria e Policisë Kufitare	Sot kjo pronë nuk është në funksion dhe kërkohet të përdoret për zyra të komunës Kelmend

**VENDIM**  
**Nr. 328, datë 16.5.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 109, DATË 17.2.2010 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË  
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË  
PËRDORIM TË KOMUNËS NIKËL, TË QARKUT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në lidhjen nr. 1, miratuar me vendimin nr. 109, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave shtohen pronat me nr. 542-550 (pesëqind e dyzet e dy deri pesëqind e pesëdhjetë), gjithsej 4 (katër) fletë, sipas lidhjes dhe formularëve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Nikël për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Nikël

<b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b>	<b>Fusha e përdorimit të pronës</b>	<b>Lloji i transferimit</b>
542	Troje të lira dhe hapësira publike ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

**VENDIM**  
**Nr. 329, datë 16.5.2012**

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE  
FINANCIARE PËR MBULIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSI  
NATYRORE OSE FATKEQËSI TË TJERA TË SHKAKTUARA NGA VEPRIMTARIA  
NJERËZORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/ 2/“dh”, dhe 8 të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Të përgjithshme

1. Shteti ndihmon financiarisht të dëmtuarit, në rastet kur, si rezultat i fatkeqësisë natyrore ose fatkeqësive të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, kanë pësuar dëme në njerëz dhe dëme materiale, në kushtet kur për përballimin e situatës:

a) është shpallur gjendja e emergjencave civile;



b) nuk është shpallur gjendja e emergjencave civile.

II. Procedurat në rastet e shpalljes së gjendjes së emergjencave civile

Në rastin e shpalljes së gjendjes së emergjencave civile, fatkeqësi natyrore, ndiqen këto procedura:

1. Evidentimi i subjekteve dhe dëmeve

a) Evidentimi i subjekteve të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore bëhet nga grupi i konstatimit, i cili ngrihet me urdhër të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore të dëmtuar.

b) Ngritja e grupeve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohen edhe formularët përkatës. Grupet e vlerësimit të dëmeve drejtohen nga përfaqësues të këshillit të qarkut përkatës.

c) Përbërja e grupeve të vlerësimit të dëmeve përcaktohet nga natyra e fatkeqësisë, nevoja për vlerësim dhe karakteri i dëmeve.

ç) Vlerësimi i dëmeve për subjektet e evidentuara nga grupi i konstatimit të njësisë së qeverisjes vendore, sipas rastit, mund të përfshijë dëmet në struktura private banimi, në orendi dhe pajisje, në infrastrukturë, në biznese, në kultura bujqësore e blegtorale, mjete mekanike, makineri dhe agregate bujqësore, si dhe në objekte social-kulturore.

2. Procedurat e vlerësimit të dëmeve, vlerësimit financiar dhe miratimit të dëmshpërblimit

a) Grupet e vlerësimit të dëmeve bëjnë vlerësimin në secilin objekt të përmendur në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij kreu, dhe plotësojnë formularët përkatës me sasinë dhe efektet financiare, të cilat i dorëzojnë në këshillin e qarkut përkatës.

b) Këshilli i qarkut, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, përgatit listat përmbledhëse për subjektet private të pronave të dëmtuara, preventivat që miratohen nga ministritë e linjës për sektorët që ato mbulojnë, si dhe plotëson dokumentacionin me certifikatën familjare, fotokopjen e dokumentit të identifikimit dhe i paraqet ato në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC), në Ministrinë e Brendshme.

c) Kur ka raste të humbjes së jetës, kërkohet dhe certifikata e vdekjes së pjesëtarit të familjes, shoqëruar me vërtetimin e komisionit mjeko-ligjor, sipas rastit.

ç) Vlerësimi financiar i dëmeve për strukturat e banimit, objektet e biznesit, strukturat me karakter bujqësor e blegtoral etj. bëhet:

- në rastet e shkatërrimit në total të tyre, sipas koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin përkatës;

- në rastet e tjera, me çmimet në fuqi, sipas zërave të punimeve të ndërtimit, miratuar nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave për qytetin përkatës, të cilat i dërgohen me shkresë zyrtare këshillit të qarkut.

d) Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në objekte sociale e publike (shkolla, spitale, qendra shëndetësore, kabina të tensionit të lartë, ujësjellës dhe kanalizimet e ujërave të zeza dhe impiantet e trajtimit për ujin e pijshëm apo të ndotur, hidrovore, argjinatura, rrugë etj.), kryhet nga grupet e vlerësimit, në përbërje të të cilëve ka ekspertë të institucioneve që kanë në pronësi apo në administrim këto objekte. Për këtë qëllim hartohen planimetritë dhe preventivat përkatës, të cilat dërgohen në DPEC, në Ministrinë e Brendshme.

dh) Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në kultura bujqësore, mjete mekanike, makineri dhe agregate bujqësore, në gjënë e gjallë dhe në bazën ushqimore (koncentrate, sanë, njomishte etj.) kryhet sipas çmimeve të tregut, të miratuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dërguar me shkresë zyrtare në këshillin e qarkut.

e) Vlerësimi për orenditë, mobilet dhe pajisjet elektroshtëpiake të dëmtuara në objektet e banimit bëhet mbi bazën e çmimeve aktuale mesatare, të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, dërguar me shkresë zyrtare këshillit të qarkut përkatës.

ë) Vlerësimi i dëmeve në makineri, mallra dhe pajisje, të dëmtuara në objektet e biznesit, kryhet në përputhje me dokumentacionin e depozituar pranë organeve tatimore e doganore dhe vlerësimi bëhet nga drejtoritë përkatëse rajonale të tatimeve.

f) Ministria e Brendshme paraqet projektvendimin për miratim në Këshillin e Ministrave, me vlerën e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësia në objektet pronë private, së bashku me listën emërore të përfituesve, si dhe vlerën e dëmeve të shkaktuara në objektet sociale e publike, të përmendura në shkronjat “ç”, “d” e “dh”.

### III. Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile

Në rastin kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës civile, fatkeqësisë natyrore, ndiqen këto procedura:

#### 1. Procedurat e vlerësimit të dëmeve

a) Familjet që kanë pësuar dëme, shkaktuar nga fatkeqësi të ndryshme natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, paraqesin kërkesën e tyre për ndihmë financiare pranë organit të qeverisjes vendore përkatëse.

b) Drejtuesi i organit të qeverisjes vendore verifikon vërtetësinë e fakteve të paraqitura në kërkesë, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të tij, i cili mban dhe procesverbalin e konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara.

c) Afati kohor nga ngritja e komisionit deri në përfundimin e hartimit të procesverbalit është 5 (pesë) ditë.

ç) Sipas rastit, me kërkesë të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, këshilli i qarkut përkatës krijon komisionin e ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objektet e banimit, i cili pas vlerësimit të dëmeve sipas përcaktimeve të bëra në shkronjën “ç” të pikës 2 të kreut II të këtij vendimi, përcakton masën e dëmshpërblimit për familjet e dëmtuara.

d) Vlerësimi për orenditë, mobiliet dhe pajisjet elektroshtëpiake të dëmtuara në objektet e banimit, bëhet në përputhje me shkronjën “e” të pikës 2 të kreut II të këtij vendimi.

dh) Afati kohor nga ngritja e komisionit deri në përfundimin e vlerësimit të dëmeve të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

e) Bashkia ose komuna harton kërkesën për dhënien e ndihmës së menjëhershme, për sigurimin e jetës dhe kushteve të përkohshme për jetesë të qytetarëve, si dhe për shpenzime të tjera për përballimin e situatës emergjente.

ë) Këshilli i komunës ose i bashkisë, pas shqyrtimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes dhe të dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, merr vendimin për dhënien e ndihmës financiare, në të cilin përmendet dhe masa e ndihmës së dhënë nga ky organ.

f) Institucioni i prefektit të qarkut konfirmon bazueshmërinë ligjore të vendimit të lëshuar nga këshilli i komunës ose i bashkisë.

#### 2. Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare:

a) Procesverbalin e konstatimit të gjendjes;

b) Vendimin e këshillit të komunës ose i bashkisë;

c) Preventivat e dëmeve nga ana ndërtimore në objektet e banimit, si dhe dëmeve në orendi, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake;

ç) Certifikata familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë;

d) Certifikata e vdekjes së pjesëtarit të familjes, kur ka raste të tilla, shoqëruar me vërtetimin e komisionit mjeko-ligjor, sipas rastit;

dh) Akt-ekspertiza nga PMNZSH-ja, në raste zjarri dhe vërtetimi nga Policia e Shtetit ose prokuroria e rrethit, në rast eksplozivi;

e) Studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licencuara, nëse është rrëshqitje toke;

ë) Konfirmimi i vendimit të njësisë së qeverisjes vendore për bazueshmërinë ligjore nga ana e institucionit të prefektit të qarkut;



f) Shkresa nga njësitë e qeverisjes vendore dhe këshilli i qarkut, ku të shprehet masa e ndihmës së dhënë për familjen e dëmtuar, në rast se ka, ose pamundësia financiare për ta ndihmuar, për mungesë fondesh.

### 3. Përcaktimi i ndihmës financiare

a) Masa e ndihmës financiare që Këshilli i Ministrave ose Ministria e Brendshme akordon në rastin e humbjes së jetës së anëtarëve të familjes, si pasojë e fatkeqësisë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për çdo person të vdekur.

b) Në rastet e dëmtimit të banesave private, masa e ndihmës bazohet në preventivin e bërë nga grupet e vlerësimit, llogaritur me çmimet në fuqi, miratuar nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave dhe në mundësitë financiare të organeve të qeverisjes vendore, Ministrisë së Brendshme ose fondit rezervë të buxhetit të shtetit apo dhe të burimeve të tjera.

c) Masa e ndihmës financiare për dëmtime masive për banesa private të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore ose të llojeve të tjera të banesave, jepet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Brendshëm dhe njësitë të qeverisjes vendore, sipas normave të strehimit në fuqi.

ç) Masa e ndihmës financiare për dëmtime individuale ose në grupe të vogla të banesave jepet nga Ministria e Brendshme ose njësitë e qeverisjes vendore, nëpërmjet fondit të miratuar në buxhetin e vitit në programin “Emergjencat civile”. Ajo do të llogaritet në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet në shkronjat “b” dhe “c” të kësaj pike dhe do të jetë 50% e vlerës së llogaritur. Për rastet kur vlera e tregut të lirë të banesave është më e ulët se vlera e banesës e llogaritur mbi bazën e kostos së ndërtimit të banesave sipas EKB-së, merret për bazë vlera e tregut të lirë të rrethit/zytetit përkatës. Bën përjashtim rasti kur sipërfaqja e banimit të banesës së vjetër është mbi normativat e strehimit sipas shkronjës “b” të kësaj pike. Në këtë rast, sipërfaqja e banesës së re dhe e vlerës së ndihmës financiare do të llogaritet sipas normave të strehimit në fuqi.

d) Në rastin e dëmtimeve në orendi, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake në strukturat e banimit, masa e ndihmës llogaritet mbi bazën e çmimeve mesatare për artikuj, përcaktuar nga strukturat e tatim-taksave.

dh) Kur studimi i kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar rekomandon ndërtimin e banesës së re në një vend tjetër, akordimi i fondeve jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

e) Dosjet me dokumentacionin përkatës të familjeve të dëmtuara, për të cilat nga ana e njësitë të qeverisjes vendore nuk është akorduar ndihma e nevojshme, sipas kriterëve të këtij vendimi, dërgohen pranë DPEC-së, në Ministrinë e Brendshme, me shkresë përcjellëse të konfirmuar nga institucioni i prefektit të qarkut.

ë) Bazuar në dokumentacionin e dërguar, vlerësuar e argumentuar nga DPEC-ja, Ministria e Brendshme akordon fonde nga buxheti i saj, të miratuara në programin “Emergjencat civile”, ose i propozon Këshillit të Ministrave dhënien e ndihmës banorëve të dëmtuar, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

f) Fondet për dhënien e ndihmës akordohen nga buxheti i njësitë të qeverisjes vendore, nga programi “Emergjencat civile” në Ministrinë e Brendshme, nga burime të tjera e donacione, si dhe nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

g) Fondet e akorduara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Brendshme u shpërndahen shtetasve, nëpërmjet njësitë të qeverisjes vendore, ku ata kanë vendbanimin.

gj) Në rastet e dëmtimeve në objektet sociale e publike, fondet e akorduara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Brendshme u kalojnë njësitë të qeverisjes vendore, bashki, komuna dhe këshillit të qarkut.

h) Fondet e akorduara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Brendshme në rastet kur përdoren për riaftësimin e infrastrukturës kritike në territorin e njësitë të qeverisjes vendore, si: ura, prita malore, rrugë, diga, argjinatura, ujësjellës dhe kanalizimet e ujërave të zeza dhe impiantet e trajtimit për ujin e pijshëm apo të ndotur etj., me arsye të motivuara përjashtohen nga procedurat normale të prokurimit, referuar nenit 5/2/c, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

IV. Të fundit

1. Për zbatimin e këtij vendimi, Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Financave nxjerrin udhëzim të përbashkët.
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 206, datë 26.3.1998 “Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish”, i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 330, datë 16.5.2012**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR PAGESËN E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE TË ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR PËR ÇËSHTJEN NR. ARB/11/24 “MAMIDOIL JETOIL GREEK PETROLEUM PRODUCTS SOCIETE ANONYME S.A. KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 19.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi 100 000 (njëqind mijë) USD, për të përballuar shpenzimet administrative të arbitrazhit ndërkombëtar për çështjen nr. ARB/11/24 “Mamidoil Jetoil Greek Petroleum Products Societe Anonyme S.A. kundër Republikës së Shqipërisë”, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investime (ICSID).
2. Ky fond, i konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën kur do të kryhet pagesa, i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.
3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr. 331, datë 16.5.2012**

**PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR NR. ARB/11/24 “MAMIDOIL JETOIL GREEK PETROLEUM PRODUCTS SOCIETE ANONYME S.A., KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi 70 000 (shtatëdhjetë mijë) euro, për të përballuar pagesat e tarifave avokatore të përfaqësimit (kësti i parë) për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. ARB/11/24 “Mamidoil Jetoil Greek Petroleum Products Societe Anonyme S.A., kundër Republikës së Shqipërisë”, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investime (ICSID).

2. Ky fond, i konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 332, datë 16.5.2012**

**PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR NR. ARB/11/18 “BURIMI S.R.L. & EAGLE GAMES, SHA, KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi 70 000 (shtatëdhjetë mijë) euro, për të përballuar pagesat e tarifave avokatore të përfaqësimit (kësti i parë), për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar “Burimi s.r.l. & Eagle Games, sh.a., kundër Republikës së Shqipërisë”, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Investime (ISCID).

2. Ky fond, i konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 333, datë 16.5.2012**

**PËR MIRATIMIN E RIALOKIMIT TË FONDEVE TË AKORDUARA, SIPAS KONTRATËS  
FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË  
INVESTIMEVE PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËS LEVAN-VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e rialokimit të fondeve të akorduara, sipas kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**RIALOKIMI**

<b>Kategoria</b>	<b>Kontributi i BEI-t pas rialokimit të kërkuar (i shprehur në euro)</b>
Punime civile	22,806,248.72
Asistencë teknike	193.751.28
<b>Totali</b>	<b>23,000,000</b>



**VENDIM**  
**Nr. 334, datë 16.5.2012**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKOZET-DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkozet-Durrës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për tokë arë me sipërfaqe 2 548 (dy mijë e pesëqind e dyzet e tetë) m<sup>2</sup>, vlerësuar me çmimin 3600 (tre mijë e gjashtëqind) lekë për m<sup>2</sup>, me një vlerë të përgjithshme prej 9 172 800 (nëntë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekësh.

3. Shuma totale e shpronësimit, prej 9 172 800 (nëntë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekësh, të përballohet nga zëri “Investime”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për vitin 2012.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 473 000 (katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Shpronësimi të fillojë në datën 16.5.2012.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimeve, që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE  
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR  
“SISTEMIM-ASFALTIM, RRUGA SHKOZET-DURRËS, NË ZONËN E KËNETËS”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Çmimi për njësi	Vlera (lekë)	Shënime
1	Bekdash	Fejzi	Agalliu	8517	156/25	Arë	2370	3600	8532000	Konfirmim nga ZVRPP-ja
2	Lulzim		Danushi	8517	171/235	Arë	40	3600	144000	Konfirmim nga ZVRPP-ja
3	Lefter	Mevlan	Gumeni	8517	171/236	Arë	40	3600	144000	Konfirmim nga ZVRPP-ja
4	Myrteza	Urim	Cenolli	8517	171/112	Arë	75	3600	270000	Konfirmim nga ZVRPP-ja
5	Petraç	Mihal	Krekas	8517	171/113	Arë	23	3600	82800	Konfirmim nga ZVRPP-ja
		<b>Shuma</b>					<b>2548</b>		<b>9172800</b>	



**VENDIM**  
**Nr. 335, datë 16.5.2012**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR HYRJA-SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor hyrja-Shkodër.
  2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme 111.3 (njëqind e njëmbëdhjetë pikë tre) m<sup>2</sup>, tokë truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 1 669 500 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë.
  4. Shpenzimet procedurale, në shumën 256 000 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
  5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 669 500 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2012, zëri “Investime”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve.
  6. Shpronësimi të fillojë më 16.5.2012.
  7. Pronari i përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilin është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja, Shkodër”, do të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
  8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarit, për të cilin është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja, Shkodër”, pasi të ketë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.
  9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Shkodër, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
  10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Shkodër, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
  11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Shkodër dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE  
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARIT QË PREKET NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRËSE-SHKODËR

Nr.	Pronari Emri-atësia-mbiemri	Nr. pas	Z.K	Tokë truall			
				Sip (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera (lekë)	Shënime
1	Gëzim Musa Alija	16/126	8597	111.3	15 000	1669500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	<b>Totali</b>			<b>111.3</b>		<b>1669500</b>	

**VENDIM**  
**Nr. 337, datë 16.5.2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 522, DATË 30.6.2010 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SHPRONËSIMI PËR  
QËLLIM TË NDËRTIMIT, PRONËSISË, SHFRYTËZIMIT, MIRËMBAJTJES DHE  
TRANSFERIMIT NË FAVOR TË SHTETIT TË PROJEKTIT TË NJË HIDROCENTRALI TË RI  
NË ASHTË, NË QARKUN E SHKODRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 522, datë 30.6.2010 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme prej 51 247 (pesëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet e shtatë) m<sup>2</sup> tokë, arë, truall, ullishte, pemëtoje, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 42 925 054 (dyzet e dy milionë e nëntëqind e njëzet e pesë mijë e pesëdhjetë e katër) lekë.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Fondi prej 42 925 054 (dyzet e dy milionë e nëntëqind e njëzet e pesë mijë e pesëdhjetë e katër) lekësh të përballohet nga fondet e shoqërisë “Energji Ashta”, sh.p.k. si subjekt kërkues i këtij shpronësimi.”.

3. Në tabelën e të shpronësuarve, që i bashkëlidhet vendimit, prona me nr. 109/1, në emër të shtetasit Jak Lazër Ndoci, bëhet në emër të shtetasit Ndrek Zef Caka, prona me nr. 130/1, në emër të shtetasit Mark Ndoc Ndoci, bëhet në emër të shtetasit Tom Pjetër Kola dhe prona me nr. 18/1 hiqet nga tabela e shpronësimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



Nr	Objekti	Emri	Alësia	Mbiemri	Lloji i Pasurisë	Z.K	Nr Pasurisë	Sp e Pasurisë (m <sup>2</sup> )	Sp shpronësimit definitiv (m <sup>2</sup> )	Çmimi tërëzim <sup>2</sup>	Vlera kompensimit (Lekë)	Shpronësim provizor					Vlera totale e kompensimit	Adresa e pronarit	Shënime
												Sasia në m <sup>2</sup>	Lloji i kulturës	Vlera Lekë/ kg	Sasia (Kv/Kg)	Vlera kompensimit (Lekë)			
1	Ashia HPP	Ndrek	Zef	Caka	ARE	3498	1091	288	288	314	90,432.00	.	pa shke, shqeg, elj	.	.	59,800	150,232.00	SPATHAR	
2	Ashia HPP	Tom	Pieter	Kola	ULLISHTE+TR UALL	3498	1301	1,940	297	930	294,030.00	.	.	.	.	0	294,030.00	SPATHAR	

**VENDIM**

**Nr. 354, datë 23.5.2012**

**PËR PEZULLIMIN E PJESSHËM DHE TË PËRKOZHSHËM TË LICENCËS SË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE, UNIVERSITETI “KRISTAL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 46 të ligjit nr.9741 datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pezullimin e pjesshëm dhe të përkohshëm të licencës së shkollës së lartë universitare jopublike, universiteti “Kristal”, për të gjitha programet në të dyja ciklet e studimit, që ofron ky institucion i arsimit të lartë.

2. Shkolla e lartë universitare jopublike, universiteti “Kristal”, gjatë periudhës së pezullimit, nuk do të pranojë studentë të rinj në asnjë nga programet e studimit që ky universitet ofron.

3. Periudha e pezullimit të licencës së këtij institucioni të arsimit të lartë zgjat për 1 (një) vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Shkolla e lartë universitare jopublike, universiteti “Kristal”, ndërmerr masat e duhura që studentët e regjistruar pranë këtij institucioni të vijojnë apo të përfundojnë studimet në programet përkatëse, sipas kohëzgjatjes normale.

5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, gjatë periudhës së pezullimit, merr masat për ushtrimin e inspektimit periodik, çdo 3 (tre) muaj, në këtë institucion, për përmirësimet e bëra në përmbushjen e standardeve shtetërore të cilësisë.

6. Në përfundim të periudhës së pezullimit të licencës, shkolla e lartë universitare jopublike, universiteti “Kristal”, i nënshtrohet akreditimit institucional sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

7. Në përfundim dhe në varësi të rezultatit të procesit të akreditimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës propozon masat përkatëse për këtë institucion të arsimit të lartë.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shkolla e lartë universitare jopublike, universiteti “Kristal”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**

**Nr. 383, datë 6.6.2012**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME NDARJE PRODHIMI PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË DET NË SHQIPËRI, BLOQET 2, 3 DHE 4 TË ADRIATIKUT, NDËRMJET “ALBPETROL”, SHA-SË, DHE SHOQËRISË “EMANUELLE ADRIATIC ENERGY LIMITED”**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në det në Shqipëri, blloqet 2, 3 dhe 4 të Adriatikut, ndërmjet “Albpetrol”, sh.a.-së dhe shoqërisë “Emanuelle Adriatic Energy Limited”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**KËRKESË**

**Nr. 872/7, datë 21.5.2012**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Bulevardi “Bajram Curri”-rruga “Ali Demi”, faza II” Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia e Tiranës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP” do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë të rifreskuar pranë Bashkisë së Tiranës (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Pronarët e pasurive, për të cilët është bërë shënimi “Bllokim hipotekor në favor të BTA”, do të likuidohen për efekt shpronësimi pasi të jetë hequr barra hipotekore.

Për pasuritë për të cilat është bërë shënimi “rikonfirmim” me pronar të pavërtetuar, personat të cilët pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e këtyre pasurive, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Për pasurinë për të cilën është bërë shënimi “Verifikim”, sqarojmë se do të verifikohen të dhënat pranë ZVRPP-së, Tiranë.

Për pasurinë me shënimin “Rikonfirmim”, sqarojmë se do të kërkohet edhe një herë konfirmimin e titullit të pronësisë pranë ZVRPP-së Tiranë.

Për pasurinë në “Proces regjistrimi”, pronari përkatës do të likuidohet për efekt shpronësimi pas përfundimit të këtij procesi, si dhe në bazë të dokumentacionit që do të dorëzojë pranë Bashkisë së Tiranës.

Vlera totale e shpronësimit është 123 619 047.2 (njëqind e njëzet e tre milionë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyzet e shtatë pikë dy) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
Sokol Olldashi



**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**BULEVARDI “BAJRAM CURRI”-RRUGA “ALI DEMI, FAZA II**

**LLOGARITJET PARAPRAKE PËR SHPRONËSIM TË PASURIVE QË PREKEN**  
**NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT BULEVARDI “B.CURRI”-“ALI DEMI”**

Nr	Pronari	ZK	Nr. Pas	Truall			Objekt			Vlera Totale lekë	Statusi juridik i pronës	Përshkrim i veçantë
				Sip.m <sup>2</sup>	Çmimi	Vlera në lekë	Sip.m <sup>2</sup>	Çmimi	Vlera në lekë			
1	Sabrie, Genci dhe Bashkim Burreli	8150	8/507	175	29829	5220075				5220075	Konfirmuar nga ZVRPP/certifikatë pronësie	Bllokim hipotekor në favor të BTA-së
2	Pronar i pavërtetuar	8150	8/271	162.4	29829	4844229.6	81	123843.2	10031299.2	14875528.8	Rikonfirmim	Sip.totale objekti 81 m <sup>2</sup> (shtëpi përdhese)
3	Pronar i pavërtetuar	8150	8/270	79	29829	2356491	48	123843.2	5944473.6	8300964.6	Rikonfirmim	Sip.totale objekti 48 m <sup>2</sup> (ndërtesë)
4	Bashkëpronarët Fazlla	8150	8/634	380	29829	11335020	197	123843.2	24397110.4	35732130.4	Konfirmuar nga ZVRPP/certifikatë pronësie	Sip.totale objekti 196.7 m <sup>2</sup> (banesë 1- kt)
5	Drita Lama; Esmë Bimo, Isa Gorica dhe Flutura Myftiu	8150	8/420	7.6	29829	226700.4				226700.4	Konfirmuar nga ZVRPP/në proces regjistrimi	Objekti nuk preket
6	Riza Hasanaj	8150	8/419	40	29829	1193160	41	123843.2	5077571.2	6270731.2	Verifikim	Sip.totale objekti 41 m <sup>2</sup> (ndërtesë)
7	Bashkëpronarët Kyçyku, Balla etj. ( BP)	8150	8/64-ND				163	123843.2	20186441.6	20186441.6	Konfirmuar nga ZVRPP/certifikatë pronësie	Sip.totale objekti 163 m <sup>2</sup> (ndërtesë 1-kt/3 dhoma me nga një depo secila)
8	Bashkëpronarët Kyçyku, Balla etj (9-BP)	8150	8/741	120	29829	3579480		123843.2		3579480	Konfirmuar nga ZVRPP/certifikatë pronësie	
9	Bashkëpronarët Pengili	8150	8/269				50	123843.2	6192160	6192160	Rikonfirmim	Sip.totale objekti 50 m <sup>2</sup> (dy dhoma)
10	Njazi dhe Mynevere Cuadari	8150	8/614				96	123843.2	11888947.2	11888947.2	Konfirmuar nga ZVRPP/certifikatë pronësie	Shtëpi 1-kt (60.5 m <sup>2</sup> )+bodrum. Sip totale (1-kt+bodrum) 96 m <sup>2</sup>
11	Bashkëpronarët Zhupani, Hyka dhe Fida	8150	8/557-ND				90	123843.2	11145888	11145888	Konfirmuar nga ZVRPP/certifikatë pronësie	Sip.totale 90 m <sup>2</sup> ndërtesë (shtëpi)
	<b>Totali</b>			<b>964</b>		<b>28755156</b>	<b>766</b>		<b>94863891.2</b>	<b>123619047.2</b>		

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 13.6.2012  
Doli nga shtypi më 14.6.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë